



09.09.2019

Fondi për Zhvillimin e Komunitetit si Përfituesi Kryesor i Granteve të Fondit Global për zbatimin e Programeve të HIV-it dhe Tuberkulozit dhe në Kosovë shpall:

SHPALLJE
Vend pune për pozitën
Infermier/e për Njësinë Mobile

I raporton: Zyrtarit/es për M&E, CDF

Pozitë me orar të plotë (40 orë për javë)

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Infermieri/ja për Njësinë Mobile ka për detyrë dhe është përgjegjës/e:

- Të zbatojë me përpikëri procedurat standarde të operimit të Njesisë Mobile;
- Të ofrojë shërbimet e këshillimit parandalues për HIV dhe IST, duke përfshirë edhe këshillat mbi shëndetin riprodhues dhe seksual dhe higjienën personale;
- Të ofrojë shërbimet e këshillimit dhe testimin për HIV në bazë të Udhërrëfyesit për shërbime të HIV testimit;
- Të ofrojë shërbimet e testimin të shpejtë vullnetar për HIV, Hepatit B, Hepatit C dhe Syfillis;
- Të regjistrojë rezultatet e këshillimit dhe testimin për të gjithë klientët në formularët përkatës të standardizuar dhe t'i dorëzojë në CDF;
- Të ofrojë shërbimet tjera të infermierisë sipas nevojës, siç janë: pastrimi i plagëve-mobilizimi i tyre, matja e tensionit, etj;
- Të përgadisë pjesën ambulatore të Njesisë Mobile duke u kujdesur për furnizimin dhe vendosjen e materialeve dhe produkteve të nevojshme për testim dhe shërbime bazike infermierike;
- Pas përfundimit të terrenit të kujdeset që të pastrojë pjesën ambulatore nga materialet e përdorura dhe të dezinfektojë hapësirën;
- Të bashkëpunojë me Mobilizuesit Social të OJQ-ve që punojnë me grupet e caktuara;
- Të bashkëpunojë dhe koordinojë me stafin e OJQ-ve që punojnë me grupet e caktuara dhe Asociacionin e Personave që jetojnë me HIV, lidhur me referimin e rasteve për testim konfirmues në IKShPK;
- Të kryejë punë organizative për Njësinë Mobile, sipas nevojës;
- Të jetë e/i gatshme për detyra tjera shtesë në rrethana specifike dhe sipas nevojës.

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Niveli i edukimit: Bachelor në infermieri;
- Të jetë i/e Licencuar nga Oda e Infermierëve të Republikës së Kosovës;
- Së paku një vjet përvojë si infermier/e në Institucionet Publike ose Private, në Organizata Jo-Qeveritare apo në organizata ndërkombëtare;
- Të ketë shkathtësi koordinuese;
- Të ketë shkathtësi ndërpersonale të mira dhe të punojë në ambiente komplekse dhe në ekip;
- I/e gatshëm të jetë fleksibil në orar të punës me qëllim të arritjes së objektivave të programit dhe të marrë përsipër detyra shtesë nëse kërkohet nga Menaxheri/ja e Programit;

- Njohja e gjuhëve zyrtare të Kosovës;
- CV me dy (2) referenca të verifikueshme dhe kopje të skanuar të Diplomës për nivelin bachelor në infermieri dhe kopjen e Licencës, duhet të dorëzohen në CDF, me e-mail në procurement.hiv.tb@kcdf.org, jo më vonë se 24 Shtator 2019 në orën 16:00.

Termat e Referencave për këtë pozicion mund të merren edhe në faqen e internetit të CDF: www.kcdf.org.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për një intervistë.

**CDF ofron mundësi të barabarta të punësimit pa marrë parasysh origjinën, përkatësinë etnike, religjionin, racën, ngjyrën, moshën dhe orientimin seksual.*